



Më 18 Mars 2020, Ministria e Financave dhe Transfereve me qëllim të zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Kosovës, për zbatimin e masave shtesë për parandalimin e Corona Virus COVID-19, ka marrë këtë:

- Vendimi Nr. 25/2020, të datuar 18/03/2020

1. Shtyhet deri në datën 30 qershor 2020 afati për dorëzimin e deklaratave në KKRF për pasivitet të vitit paraprak afarist për shoqëritë tregtare, shoqëri të cilat gjatë vitit afarist nuk kanë pasur aktivitet afarist dhe nuk ka regjistruar asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet në librat kontabël, në pajtim me Nenin 18, të Ligjit Nr. 06/L-32 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim".
2. Shtyhet deri në 30 qershor 2020, afati për dorëzimin në KKRF të pasqyrave vjetore financiare, përkatësisht pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara, raportin e menaxhmentit, raportin e konsoliduar të menaxhmentit dhe raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare, specifikisht raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare, në pajtim me Nenin 18, paragrafi 1.1., të Ligjit Nr. 06/L-32 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim".
3. Shtyhet deri më 30 qershor 2020, dorëzimi në KKRF i pasqyrave vjetore financiare, respektivisht pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raporti i rishikimit të pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare, në pajtim nenin 17, të Ligjit Nr. 06/L-32 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim".
4. Shtyhet deri 30 qershor 2020, afati për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituar në pajtim me SNA-të në KKRF dhe publikimi i tyre si dhe dorëzimi i tyre në ministrinë përkatëse për tregti dhe industri, në pajtim me Nenin 17, të Ligjit Nr. 06/L-32 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim".
5. Shtyhet deri më 30 qershor 2020 afati për dorëzimin në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe në KKRF të pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informata shtesë lidhur me vitin paraardhës kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera, në pajtim me Nenin 19, të Ligjit Nr. 06/L-32 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim".

Ky dokument behet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe / ose angazhim të cdo lloji natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:

tax_legal-alko@deloittece.com



On 18 March 2020, the Ministry of Finance and Transfers with purpose of implementing decision of the Government of Kosovo for implementing additional measures for prevention of the Corona Virus COVID -19, has rendered

- Decision No. 25/2020, dated 18/03/2020

1. It is postponed up to 30 June 2020, the term for submission of declarations for previous financial year with Kosovo Council for Financial Reporting ("KCFR"), for passive business organizations, which they did not conduct business activity and did not registered any data on assets and liabilities in the accounting books, based on Article 18, paragraph 4 of the Law No. 06/L-32 "On Accounting, Financial Reporting and Auditing".
2. It is postponed up to 30 June 2020, submission annual financial statements and consolidated annual financial statements with KCRF, management report, consolidated management report, and audited financial statements, namely consolidated audited financial statements by the business organizations, as it is provided in Article 18, paragraph 1.1, of the Law No. 06/L-32 "On Accounting, Financial Reporting and Auditing".
3. It is postponed up to 30 June 2020, submission with KCRF of annual financial statements, respectively consolidated annual financial statements and revised report of consolidated financial statements from business organizations, as it is provided in Article 17, paragraph 1, of the Law No. 06/L-32 "On Accounting, Financial Reporting and Auditing".
4. It is postponed up to 30 June 2020, submission with KCRF of audited financial statements in accordance with ISA, and their submission in the Ministry of Trade and Industry, as it is provided in Article 17, paragraph 1, of the Law No. 06/L-32 "On Accounting, Financial Reporting and Auditing".
5. It is postponed up to 30 June 2020, submission with the Kosovo Agency for Statistics and KCRF of position of financial statements, accounts of profits and losses and additional information for previous financial year for statistical and other purposes, in accordance with Article 19, paragraph 1, of the Law No. 06/L-32 "On Accounting, Financial Reporting and Auditing".

This document is delivered for informative purposes only. It does not constitute legal/tax counsel and/or commitments of any nature. For any further clarification please contact:

tax_legal-alko@deloittece.com